

<b>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</b>	<b>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</b>	<b>POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU</b>
---	--	--

**ASC-10-0014**

Në padinë e

██████████ avokat

██████████ Zveçan

në emër të ndjerës ██████████

† 21 korrik 1968,

██████████ Republika e Serbisë

Paditësi/Ankuesi

kundër

**1. Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Rr. 8 Ilir Konuchevci, Prishtinë

**2. ██████████**

Vushtrri

Të Paditurat

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS) i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, në ankesën e Miro Delević kundër aktvendimit të Trupit Gjykses të 24 nëntorit 2009, SCC-09-0129, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 maj 2010, lëshon këtë

**AKTVENDIM**

- 1. Ankesa refuzohet si e papranueshme.**
- 2. Kërkesa për ndërprerje të procedurës refuzohet si e papranueshme.**
- 3. Avokati ██████████ obligohet t'i paguaj taksat gjyqësore në shumë prej 60 eurosh në Dhomën e Posaçme.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Më 26 janar 2010, avokati [REDAKTUAR] në emër të [REDAKTUAR] ushtroi ankesë kundër aktvendimit të Trupit Gjykes të datës 24 nëntor 2009, SCC-09-0129, me anën e të cilit u hedh poshtë si e papranueshme padia e ushtruar në emër të [REDAKTUAR] si Paditëse. Më 10 shkurt 2010, avokatit [REDAKTUAR] iu kërkua të përmbushë nenin 60.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut (UA) 2008/6 duke e dorëzuar një kopje të vërtetuar të autorizimit dhe përkthimin në anglisht të ankesës dhe e të gjitha dokumenteve mbështetëse. Më 22 mars 2010, ai e ushtroi një parashtresë me të cilën e njoftoi gjykatën se ai nuk kishte mundësi të përmbushë kërkesat e përmendura më lartë për shkak të vdekjes së Paditëses, në të njëjtën kohë kërkoi nga DHPGJS-ja të ndërpresë procedurën në këtë lëndë derisa të përfundojë procedura e trashëgimisë. Më 25 mars 2010, avokatit [REDAKTUAR] iu kërkua të paraqesë sqarimin se kur ka ndërruar jetë klientja e tij [REDAKTUAR] dhe dëshminë se ai ishte autorizuar të përfaqësojë klienten e tij të ndjerë në procedurat pran DHPGJS-së.

Më 12 prill 2010, avokati [REDAKTUAR] sqaroi se [REDAKTUAR] vdiq më 21 korrik 1968 në Beograd, duke e lënë një autorizim me të cilin autorizohet kushëriri i saj [REDAKTUAR] në lidhje me kthimin e pronës së saj në Kosovë. [REDAKTUAR] e transferoi këtë autorizim te kushëriri i tyre i përbashkët [REDAKTUAR], i cili pastaj e autorizoi avokatin [REDAKTUAR] për procedurën e tanishme. Për më tepër, ai pohoi se gjendet një "procedure e re e trashëgimisë" në lidhje me pronën e të ndjerës [REDAKTUAR] e cila është në pritje në Gjykatën e Dytë Komunale të Beogradit. Në bazë të arsyeve të dhëna më lartë, ai kërkoi që procedura të pezullohet deri të finalizohet procedura e trashëgimisë.

**Arsyetimi Ligjor:**

Ankesa është e pranueshme, por e pabazuar. Gjithashtu, kërkesa për ndërprerjen e procedurës duhej të refuzohej si e pabazuar.

*Mundësia për të qenë palë në lëndën në fjalë*

### III

Personi i vdekur nuk mund të jetë palë në një padi dhe nuk mund të iniciojë procedurë ligjore; dhe nuk mund të ushtrohet ndonjë parashtresë në emër të tyre (në veçanti: padi dhe ankesa) dhe as për ta (krahaso nenin 77 të Kodit të Procedurës Civile, Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596 e RSFJ ["LPC"]; shih gjithashtu nenin 73.1 të Ligjit të Kosovës për Procedurën Kontestimore ["LKPK"], ligji nr. 03/L-006, i cili thotë se palë në procedurë mund të jetë çdo person fizik apo juridik, që përfshinë ekzistimin e tyre, për "person fizik" që nënkupton se ai/ajo duhet [ende] të jetë gjallë.

Në parim, vetëm pasardhësi(t) ligjor të personit të ndjerë është/janë legjitim për të iniciuar procedurë në lidhje me marrëdhëniet ligjore të ndjerit, mbi të gjitha, dhe vetëm në emrin e tij/saj/tyre, duke pohuar dhe (më vonë) të vërtetohet trashëgimi i tyre ligjor i personit të ndjerë (apo në rrethana të caktuara, kujdestari i trashëgimisë përderisa çështja e trashëgimisë ligjore është ende e pazgjidhur).

██████████ ka vdekur më 21 korrik 1968. Padia është ushtruar në emër të saj më 13 korrik 2009, fare pa e treguar vdekjen e saj. Nga parashtresa e avokatit ██████████ është e qartë se ai definitivisht kishte për qëllim ushtrimin e padisë në emër të saj, dhe jo (në mënyrë të fshehur) në emër të ndonjë trashëgimtari të saj ligjor. Ai pohoi se e ndjera ██████████ e kishte lënë një autorizim për kushëririn e saj ██████████ në mënyrë që të kthejë pronën e saj në Kosovë, i cili pastaj e kaloi te kushëririn e saj ██████████ i cili në fund e autorizoi atë (ky autorizim, përndryshe, asnjëherë nuk është prezantuar në procedurën e Trupit Gjyqësor, dhe as një procedurën e Kolegjit të Ankesave).

Ai, prandaj, definitivisht dhe qëllimisht e inicioi procedurën në emër të personit të ndjerë. Si rrjedhojë, pyetja teorike e sqarimit të njoftimit të një pale (ekzistuese) gjatë periudhës së procedurës, për shkak të denominimit të rrejshëm të subjektit ekzistues, mund të mbetet e pa përgjigjur këtu.

Për këto arsye ankesa e lëshuar në emër të personit të ndjerë është e pranueshme, pasi që avokati ankues ██████████ është legjitim të veprojë si palë vet në procedurën ankimore duke u marrë saktësisht me çështjen e të drejtës

për pjesëmarrje në procedurë si palë; megjithatë, është e pabazuar për shkak të arsyeve të dhëna.

### Kërkesa për ndërprerje të procedurës

Avokati [REDAKTUAR] gjithashtu kërkoi ndërprerjen e procedurës së tanishme derisa të finalizohet procedura e trashëgimisë në Gjykatën e Dytë Komunale të Beogradit.

Në pajtim me nenin 13.2 (vi) të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, DHPGJS-ja mund të "ndal të tërë procedurën apo pjesë të saj, apo Aktvendim apo Aktgjykim, në përgjithësi ose deri në një datë apo rast të specifikuar", pa i specifikuar rrethanat në të cilat kjo ndërprerje do të duhej të ndodhte. Megjithatë, është e qartë se ndalimi i procedurës nuk është lënë në diskrecionin e vetëm të DHPGJS-së. Në bazë të nenit 212 (1) të LPC-së (dhe nenit 277.1 a) të LKPC-së) procedura do të ndalohet kur pala vdes apo e humbë mundësinë procedurale dhe nuk ka përfaqësues të autorizuar.

Në përputhje me parimet e përgjithshme, rrjedh nga këto rregulla se ndalimi i procedurës mund të bëhet vetëm nëse krijohen rrethana specifike gjatë procedurës, të cilat nuk kanë ndodhur para inicimit të saj. Në veçanti, ndërprerja e procedurës duhet të urdhërohet vetëm në situatë kur pala vdesë gjatë procedurës, përderisa dispozitat e përmendura nuk përfshijnë paditë e ushtruara në emër të peronave (tani më) të vdekur.

Prandaj, edhe kërkesa për të ndaluar procedurën duhej të refuzohej si e pabazë. Nuk është më tutje relevante se çfarë do të jetë përmbajtja (meritat) e procedurës trashëgimore të pretenduar në Beograd.

Pasi që Trupi Gjykses nuk ka lëshuar vendim mbi meritat, trashëgimtari potencial ligjor i të ndjerës [REDAKTUAR] mund të ushtrojë padi të re në Trupin Gjykses, e cila përmbushë kërkesat e përcaktuara me ligj.

### Taksat Gjyqësore

Në bazë të nenit 2 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës të 3 tetorit 1987), individët mbi propozimin apo

interesin e të cilëve ndërmerren veprimet në procedurë do t'i paguajnë taksat e përcaktuara me këtë ligj. Në lëndën në fjalë avokati [REDACTED] ka ushtruar padi pa autorizim të palës – ekzistuese – dhe, prandaj, shihet si individ mbi propozimin e së cilit janë ndërmarrë veprimet në procedurë.

Në bazë të Rregullave Plotësuese Procedurale të DHPGJS-së në lidhje me Taksat Gjyqësore të cilat janë në fuqi që nga 10 marsi 2010 (në bazë të nenit 57.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6), aplikohen këto taksa gjyqësore për procedurën ankimore (shih ASC-09-0072 et al):

Tarifat e taksave gjyqësore, neni 10.11 (ushtrimi i ankesës)	30 Euro
Tarifat e taksave gjyqësore, neni 10.15 lidhur me 10.21 dhe 10.1 (aktvendimi në shkallën e dytë)	30 Euro
Gjithsej	60 Euro

Për arsyet e dhëna më lartë, këto taksa gjyqësore do të barten nga Ankuesi, i cili është i obliguar të paguaj shumën e përmendur në DHPGJS (shih nenin 2 [1] të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës të 3 tetorit 1987).

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it [nënshkrimi]

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it [nënshkrimi]

Eija-Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it [nënshkrimi]

Tobias Lapke, Regjistruer i EULEX-it [nënshkrimi]